



Nr. 3003/1 Prot  
Dt. 08.05.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 314/1 prot

Shkodër, më 08.05.2024

**LËNDA: Mbi vendimin Nr.28, datë 29.04.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.**

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", Urdhërit të Kryeministrit nr.50 datë 12.4.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit Qarkut Shkodër", të Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 49/pika 2, 3, 4/e, neni 54 gërma j, neni 55/3, shqyrtoi **vendimin Nr.28, datë 29.04.2024** të Këshillit Bashkiak Vau Dejës sipas dokumentacionit shoqërues dërguar me shkresën e Këshillin e Bashkiak Nr.3002 Prot, datë 3.05.2024 "Humbje mandati Paola Pleshaj, përfaqësuese e subjektit zgjedhor Partia Socialiste, si pasojë e mosmarrjes pjesë në mbledhjet e KB për një periudhë 6-mujore".

Prefekti ju lejon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

VENDIM

Nr. 28 .datë 29.04 .2024

PËR:

“Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 49, pika 2,pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:

VENDOSI:

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Znj.Paola Pleshaj**, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me date 03.05.2024



Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 2617 Prot.

Vau Dejës me 19/09/2024

**PROJEKT VENDIM**

**PËR:**

**“Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës”**

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 2, pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Znj. Paola Pleshaj**, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.

**Kryetari Këshillit**

**Ervis Shimaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa,Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail:info@vaudejes.gov.al)

**RELACION**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 4, germa e,dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës"neni 21, pika 1, germa g, ju raportoj si më poshtë:

Këshilltarja e Këshillit Bashkiak Vau Dejës,Znj.Paola Pleshaj (përfaqësuese e subjektit politik P.S) nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për një periudhë 6-mujore rresht,dhe konkretisht:Nga mbledhja e muajit Tetor 2023 deri në mbledhjen e muajit Mars 2024. Sqaroj se Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka zhvilluar mbledhje normale të rradhës për ç`do muaj si më poshtë:

Mbledhja e muajit Tetor është bërë me datë 30.10.2023.

Mbledhja e muajit Nëntor është bërë me datë 30.11.2023.

Mbledhja e muajit Dhjetor është bërë me datë 21.12.2023.

Mbledhja e muajit Janar është bërë me datë 26.01.2024.

Mbledhja e muajit Shkurt është bërë me datë 27.02.2024.

Mbledhja e muajit Mars është bërë me datë 27.03.2024.

Në të gjitha këto mbledhje të Këshillit Bashkiak Vau Dejës,Këshilltarja Znj.Paola Pleshaj ka munguar pa shprehur ndonjë arsye.

Sa më sipër :

**Kryetari Këshillit**

**Ervis Shimaj**

